



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

NJOFTIM PARAPRAK PËRQËNDRIMI

Mbi përqendrimin nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Euromax Sh.p.k nga CM Balkans B.V

Në datën 20 Mars 2013, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të “Kontratës për Shitblerjen e Kuotave”, të nënshkruar ndërmjet palëve (“CM Balkans B.V” në cilësinë e blerësit dhe “Balfin Sh.p.k” në cilësinë e shitësit) më datë 6 Mars 2013, me objekt përfitim të kontrollit të shoqërisë Euromax Sh.p.k nga shoqëria CM Balkans B.V nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse në përqendrim është si vijon:

-Blerësi, CM Balkans B.V: ushton veprimtarinë e saj në fushë e themelimit, blerjes, menaxhimit ose drejtimit në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të shoqërive që operojnë në aktivitete të shitjes me pakicë të produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore në Europën Juglindore, etj;

-Shitësi, Balfin Sh.p.k: ushtron veprimtarinë e saj në fushën e import- eksportit, shitjes me shumicë dhe pakicë të mallrave industrialë dhe ushqimorë, tregtimin e mallreve të ndryshëm, transportin e mallrave, etj;

-Ndërmarrja objekt përqëndrimi, Euromax Sh.p.k: ushtron veprimtarinë e saj në fushën e trgtimit me pakicë të produkteve ushqimore me anë të rrjetit të saj prej 18 dyqaneve Euromax në të gjithë Shqipërinë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b dhe 12, pika 1 të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al